

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1041 Prot.

Tiranë, më 02.08 2017

VENDIM Nr. 170, datë 26.07.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.10, datë 26.07.2017, pasi shqyrtoi Kërkesën e Z. Kastriot Lalollari, Mykis Gjonmadhi për rikonstruksion të banesës 2-3 kat + podrum, të ndodhur në rrugën "Ndre Mjeda", pozicionuar në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Korçës,

VENDOSI:

1. Të miratojë Kërkesën e Z. Kastriot Lalollari, Mykis Gjonmadhi për rikonstruksion të banesës 2-3 kat + podrum, të ndodhur në rrugën "Ndre Mjeda", pozicionuar në zonën arkeologjike "B", të qytetit të Korçës.
2. Punimet e rikonstruksionit dhe sistemimit nuk duhet të jenë punime gërmimi dhe ndërhyrje në territor.
3. Në rast se gjatë zbatimit të punimeve të sipërpërmendura identifikohen gjetje arkeologjike, bazuar në nenin 48 të ligjit 9048, datë 7.4.2003 "Për Trashëgiminë kulturore" (i ndryshuar), subjekti zbatues duhet të ndërpresë menjëherë punimet dhe të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARDI FURXHI
MINISTËR



SEKRETARI KKA
RUDINA ZOTO